**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

# DOKUMENTET E PROCEDURËS KONKURRUESE PËR DHËNIEN ME KONCESIONIN/PPP, NDËRTIMIT DHE MIRËMBAJTJES TË SEGMENTIT RRUGOR PORTI I JAHTEVE - BYPASS ORIKUM - DUKAT (Ura e Shën Elizës)

Open Procurement Albania

**Korrik 2018**

# 1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

## 1.1. Objektivi i Procedurës Konkurruese

Autoriteti Kontraktues ka vendosur të japë një koncesion për "Ndërtimin dhe Mirëmbajtjen e Segmentit Rrugor "***Porti i Jahteve - Bypass Orikum - Dukat (Ura e Shën Elizës)",*** përmes një procedure koncesioni/partneriteti publik privat, në përputhje me termat e Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.

## 1.2. Ofertuesit e Mundshëm

Të gjithë palët e interesuara janë të ftuar të dorëzojnë Dokumentet e Ofertës për Projektin.

## 1.3. Përshkrimi i Përgjithshëm i ndërtimit të Rrugës

Projekti ka si objekt projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor **Porti i *Jahteve - Bypass Orikum - Dukat (Ura e Shën Elizës),*** e cila fillon në rrugën e Portit të Jahteve, për të kaluar më pas në Bypass Orikum dhe përfundon në Dukat (Ura e Shën Elizës).

Rruga që përdoret për ndërlidhjen e zonave bregdetare të jugut për mjetet e transportit nga Orikumi në Dukat deri në lokacionin e quajtur Ura e Shën Elizës sot është e degraduar dhe me gjatësi 16 km. Gjatë stinës së verës përgjatë gjatësisë së saj ndeshemi me formimin e kolonave të trafikut automobilistik. Situatë e krijuar kryesisht nga fluksi i madh i turistëve në këtë zonë. Ndërsa gjatë stinës së dimrit kushtet teknike për kalimin e këtij segmenti, lidhur ngushtë me karakteristikat gjeografike të zonës, përkeqësohen duke rritur rrezikun e incidenteve që mund të ndodhin në të.

Open Procurement Albania

Projekti në fjalë përveç lehtësirave të drejtpërdrejta që do të krijojë në zonë, duke bërë më të lehtë hyrjen në Rivierën e Jonit Shqiptar për vizitorët, do të favorizojë edhe planifikimin urban, duke bërë që ndërtimi i kësaj infrastrukture strategjike për zhvillimin e zonës përreth do të kushtëzojë që planifikimi urban të mbështetet mbi këtë rrugë. Mendohet që kjo rrugë të jetë strategjike për 50 vitet e ardhshme të zhvillimit të zonës së bregdetit. Vlerësimi i një periudhe kaq të gjatë jetëgjatësie do të bëjë të mundur të ulë koston për zhvillimin urban për vitet në vazhdim.

Një infrastrukturë e tillë do të mundësojë një lidhje më të favorshme për zonën duke favorizuar rritjen e personave që do të vizitojnë këtë zonë si dhe të ulë kostot e transportit duke mundësuar çmime më të ulëta të produkteve parësore për nevojat primare të komunitetit që do të jetojë në këto zona. Çmime të ulëta do të thotë më shumë fuqi ekonomike për popullsinë vendase që jeton në këto zona.

# 2. Përmbledhja e kushteve kryesore të proçedurës konkurruese.

Objekti kryesor i kësaj procedure është dhënia me konçesion /PPP "*Për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Segmentit Rrugor Porti i Jahteve - Bypass Orikum - Dukat (Ura e Shën Elizës)",* sipas parimit të "Projektit me Çelsa në dorë". Kushtet thelbësore të kësaj procedure përfshijnë por pa u kufizuar kushtet e mëposhtme:

***1.*** Objekti i kontratës se koncesionit/PPP: "*Ndërtimi dhe Mirëmbajtja e Segmentit Rrugor Porti i Jahteve - Bypass Orikum - Dukat (Ura e Shën Elizës)"*

**2.** Kohëzgjatja e kontratës së koncesionit/PPP: 13 vjet

**3.** Aktivitetet për t'u kryer nga koncesionari: "*Projektimi, Ndërtimi dhe Mirëmbajtja e*

*Aksit Rrugor Porti i Jahteve - Bypass Orikum - Dukat (Ura e Shën Elizës)"* sipas standardeve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues.

4. Burimet e të ardhurave të Koncesionarit: një pagesë disponueshmërie vjetore e pagueshme nga Autoriteti Kontraktues për Koncesionarin.
   Pagesa e pare e këstit do te kryhet nga Autoriteti Kontraktues, kur Koncesionari te ketë kryer jo me pak se 25% te volumit te punimeve
5. Legjislacioni i zbatueshëm: Kontrata e Koncesionit do të rregullohet nga Legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.

## 2. NJOFTIM KONTRATE

### Seksioni 1 Autoriteti Kontraktues

**1.1** Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Adresa Rruga "Abdi Toptani ", Nr. 1, Tiranë

E-mail etleva.kondi@infrastruktura.gov.al ;
cc ada.oseku@infrastruktura.gov.al ;
ervin.duraj@infrastruktura.gov.al

Faqja e Internetit www.infrastruktura.gov.al

Open Procurement Albania

Emri dhe adresa e personit të kontaktit

Emri Etleva Kondi

Adresa: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Rruga "Abdi Toptani ", Nr. 1, Tiranë
Tirana, Albania

Email:

Çdo komunikim, pyetje, sqarim ose informacion që kërkohet nga Ofertuesit e Mundshëm rreth Procedurës së Tenderit duhet t'i adresohet me e-mail Personit të Kontaktit të sipërcituar.

**1.2 Lloji i autoritetit kontraktor dhe aktiviteti ose aktivitetet kryesore**:

Institucion qendror X    Institucion i pavarur ☐

Njësi e Qeverisjes Vendore ☐

### Seksioni 2 Objekti i Kontratës

**2.1 Lloji i Kontratës**

Kontratë koncesioni /PPP (punë publike).

## 2.2 Përshkrim i shkurtër i kontratës

*2.2.1 Forma e Kontratës:* Koncesion/PPP

*2.2.2 Objekti i Kontratës*: Ndërtimi dhe Mirëmbajtja e Segmentit Rrugor Porti i Jahteve - Bypass Orikum - Dukat (Ura e Shën Elizës).

## 2.3 Kohëzgjatja e Kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja 13 (trembëdhjetë) vjet

## 2.4 Vendndodhja e Objektit të Kontratës

Ndërtimi i rrugës fillon në rrugën e Portit të Jahteve, për të kaluar më pas në Bypass Orikum dhe përfundon në Dukat (Ura e Shën Elizës).

## 2.5 Ndarja në LOTE:

Po□ Jo ☑

Nëse po:

Open Procurement Albania

## 2.6 Përshkrimi i shkurtër i lotëve: n.a.

1________________________________________

2________________________________________

3________________________________________

## 2.7 Opsionet:

Numri i rinovimeve të mundshme (*nëse ka*): n.a

## 2.8 Do të pranohen variantet

Po□ Jo ☑

*2.8.1 Do të pranohet nënkontraktimi:*

Po ☑ Jo □

Nëse do të lejohet nënkontraktimi, të specifikohet përqindja e lejuar për nënkontraktim:

Autoriteti Kontraktor do t'i bëjë pagesa të drejtpërdrejta nënkontraktorit:

Po □ Jo ☑

## 2.9 Kontratë në kuadër të një Marrëveshjeje të veçantë ndërmjet Shqipërisë dhe një shtet Tjetër

Po □ Jo ☑

## 2.10 Vlera e Parashikuar e Projektit

Vlera e parashikuar e projektit është 50,575,020 Euro.

**2.11. Monedha:** Monedha e ofertës do të jetë në **Euro**

## Seksioni 3 Informacion ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik

### 3.1 Kriteret e Pranimit dhe kriteret e vlerësimit

Sipas **Shtojcës 9**

**3.2 Sigurimi i Ofertës kërkohet të jetë 2% (dy%) e vlerës së parashikuar të projektit vlerë e përgjithshme e projektimit+ndërtimit +mirëmbajtje, te vlerës se parashikuar sipas përcaktimit te pikës 2.10.**

Operatori ekonomik që të marrë pjesë në një procedurë konkurrimi, kërkohet që të paraqesë Sigurimin e Ofertës, i plotësuar në përputhje me modelin e bashkangjitur si Shtojca 6 e DPK;

## Seksioni 4 Procedura

### 4.1 Lloji i Procedurës:

☑ E hapur

□ E kufizuar

Open Procurement Albania

### 4.2 Kriteret e Vlerësimit:

| Nr. | Kriteret | |
|---|---|---|
| **1** | **Propozimi teknik për ndërtimin e rrugës dhe mirëmbajtjes.** | |
| | a | Projekt ide/propozim |
| | b | Metodologjia e punimeve |
| | c | Plani operacional i mirëmbajtjes dhe disponueshmërisë |
| | d | Sinjalistika e përkohshme dhe Siguria në kantier gjatë ekzekutimit të punimeve të ndërtimit |
| **2** | **Ndikimi mjedisor** | |
| **3** | **Ndikimi social** | |
| **4** | **Interesi i Kapitalit te vet** | |
| **5** | **Afati i përfundimit të punimeve** | |
| **6** | **Oferta Financiare** | |

### 4.3 Afati i fundit Dorëzimit të Ofertave është:

Data: 20 Shtator 2018, Ora: 12.00 MD Ora e Evropës Qendrore

Ofertuesit e Mundshëm do të dorëzojnë Dokumentet e Ofertës së tyre në shqip, në format elektronik, duke i ngarkuar ato përpara Afatit të Dorëzimit në portalin në internet të Agjencisë së Prokurimeve Publike të Shqipërisë në www.app.gov.al Ofertat e dorëzuara pas Afatit të Dorëzimit te përcaktuar, do të refuzohen.
Udhëzimet për ngarkimin e Dokumenteve të Ofertës mund të gjenden në gjuhët shqipe dhe angleze në portalin në internet të Agjencisë së Prokurimeve Publike të Shqipërisë në www.app.gov.al.

### 4.4 Afati kohor për hapjen e ofertave:

Data: 20 Shtator 2018, Ora: 12.00 MD Ora e Evropës Qendrore

### 4.5 Periudha e Vlefshmërisë së Ofertave:

Çdo Ofertë do të jetë e vlefshme për një periudhë prej 180 dite pas afatit të Dorëzimit.

### 4.6 Gjuha e ofertës:

Shqip ☑ Anglisht □

Tjetër □

## Seksioni 5 Informacione Plotësuese

### 5.1 Qendra Virtuale e të Dhënave

Një Ofertues i Mundshëm do të gjejë të gjithë informacionin lidhur me Kontratën: specifikimet minimale teknike, kriteret e kualifikimit si dhe ato te vlerësimit, në faqen elektronike Agjencisë së Prokurimeve Publike: www.app.gov.al

Open Procurement Albania

### 5.2 Pyetjet

Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë modifikime për dokumentet e procedurës konkurruese nga Autoriteti Kontraktor, brenda 10 ditëve nga publikimi i Ftesës për Ofertë. Autoriteti Kontraktor duhet t'i përgjigjet çdo kërkese për sqarim të dokumenteve të procedurës, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 (pesë) ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

Autoriteti Kontraktues duhet të përgjigjet brenda 3 (tre) ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përmes faqes elektronike www.app.gov.al

Autoriteti kontraktues në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e procedurës konkurruese, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë komunikohet përmes faqes elektronike www.app.gov.al

### 5.3 Të Dhënat dhe Informacion mbi Projektin objekt koncesioni /ppp

Projekti objekt koncesioni/ppp, ka si objekt projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor Porti i Jahteve - Bypass Orikum - Dukat (Ura e Shën Elizës), e cila fillon në rrugën e

Portit të Jahteve, për të kaluar më pas në Bypass Orikum dhe përfundon në Dukat (Ura e Shën Elizës).

Rruga që përdoret për ndërlidhjen e zonave bregdetare të jugut për mjetet e transportit nga Orikumi në Dukat deri në lokacionin e quajtur Ura e Shën Elizës sot është e degraduar dhe me gjatësi 16 km. Gjatë stinës së verës përgjatë gjatësisë së saj ndeshemi me formimin e kolonave të trafikut automobilistik, situate e krijuar kryesisht nga fluksi i madh i turistëve në këtë zonë. Ndërsa gjatë stinës së dimrit kushtet teknike për kalimin e këtij segmenti, lidhur ngushtë me karakteristikat gjeografike të zonës, përkeqësohen duke rritur rrezikun e incidenteve që mund të ndodhin në të.

Projekti në fjalë përveç lehtësirave të drejtpërdrejta që do të krijojë në zonë, duke bërë më të lehtë hyrjen në Rivierën e Jonit Shqiptar për vizitorët, do të favorizojë edhe planifikimin urban, duke bërë që ndërtimi i kësaj infrastrukture strategjike për zhvillimin e zonës përreth do të kushtëzojë që planifikimi urban të mbështetet mbi këtë rrugë. Mendohet që kjo rrugë të jetë strategjike për 50 vitet e ardhshme të zhvillimit të zonës së bregdetit. Vlerësimi i një periudhe kaq të gjatë jetëgjatësie do të bëjë të mundur të ulë koston për zhvillimin urban për vitet në vazhdim.

Objektivat kryesore të projektit janë:

1. Lehtësimi i trafikut në zonën bregdetare jugore, i cili eshte shumë problematik sidomos gjatë sezonit turistik.
2. Zhvillimi i turizmit, duke qenë se ky segment rrugor do të bëjë të mundur ndërlidhjen e pikave të reja strategjike siç është edhe Porti i Jahteve.

### 5.4 Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

Përveç rasteve të deklaruara ndryshe, të gjitha referencat e kostove, shpenzimeve, tarifave dhe çmimeve do të shprehen pa TVSH.

Open Procurement Albania

### 5.5 Kufizime

E drejta për të pezulluar dhe anuluar, procedurën konkurruese:
Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën për të pezulluar ose anuluar procedurën konkurruese dhe ne këto raste Ofertuesit e mundshëm nuk kanë të drejtë të kërkojnë kompensim, kosto ose shpenzime.

## 6. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME PËR PROCEDURAT KONKURRUESE

Autoriteti Kontraktues do të zbatojë procedurën konkurruese:

***i) PROCEDURA E HAPUR***

**Autoriteti Kontraktues** ***Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë***

Publikon ftesën për propozim duke ftuar të gjithë operatorët ekonomikë të paraqesin ofertat e tyre në këtë procedurë konkurruese me qëllim realizimin e punëve dhe shërbimeve të përshkruara më poshtë:

"*Ndërtim dhe mirëmbajtje te segmentit rrugor Porti i Jahteve - Bypass Orikum - Dukat (Ura e Shën Elizës)*".

Kandidatët do të dorëzojnë propozimin sipas përcaktimeve të bëra në dokumentet e procedurës konkurruese. Autoriteti Kontraktues, do të shqyrtojë propozimet e dorëzuara nga Kandidatet dhe do te vlerësojë nëse janë përmbushur kërkesat ligjore, tekniko-ekonomike, propozimi teknik, nëse është i aplikueshëm, sigurimin e ofertës dhe vendimin e organeve drejtuese vendimmarrëse të ofertuesit të mundshëm, si dhe ofertën financiare sipas përcaktimeve te bëra ne DPK.
Kandidatet, qe nuk plotësojnë kriteret e kualifikimit, si dhe nuk paraqesin sigurimin e ofertës, si dhe paraqesin një model financiar me vlere me te larte se ai i përcaktuar ne shtojcën 21 s'kualifikohen dhe njoftohen menjëherë, për këtë skualifikim. Oferta financiare do te jete objekt vlerësimi vetëm për ata kandidate te cilët përmbushin kriteret e kualifikimit.

Për te marrë pjesë në procedurën konkurruese kandidatet duhet te plotësojnë minimalisht kërkesat e përcaktuara ne Shtojcën 9;

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin ofertën e tyre: Në faqen zyrtare te Agjencisë se Prokurimit Publik: https://www.app.gov.al

Jo me vone se data **20 Shtator 2018** ora [12:00]

## 7. UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË

**7.1** Hartimi i kërkesës/propozimit: Kandidatet/Ofertuesit janë të detyruar të përgatisin kërkesat/propozimet, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DPK. Kërkesat/propozimet që nuk përgatiten në përputhje me DPK do të refuzohen si të papranueshme.

**7.2** Kandidatët/ofertuesit e mundshëm përballojnë kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesave propozimeve të tyre, si dhe vizitën ne terren. Autoriteti Kontraktues nuk është përgjegjës për këto kosto.

**7.3** Për procedurat konkurruese që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i kërkesës/ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e kërkesës/ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numërtohen.
Në rast të ofertave të paraqitura nga një bashkim operatorësh ekonomikë, oferta duhet të shoqërohet me Prokurën e noterizuar, për Personin (-at) e Autorizuar (nëse do të jetë i ndryshëm nga drejtuesi ligjor) që do të përfaqësojnë bashkimin gjatë procedurës konkurruese. Operatori ekonomik, pjesëtar i një bashkimi operatorësh nuk mund të paraqesë njëkohësisht dhe ofertë individualisht. Bashkimi i operatoreve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës deri në nënshkrimin e kontratës. Në të kundërt oferta e tij refuzohet. Shtimi i anëtarëve të tjerë në përbërjen e bashkimit të operatorëve ekonomikë është i mundshëm pas nënshkrimit të kontratës dhe vetëm me aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktues. Çdo operator ekonomik duhet të përmbushë secili më vete kërkesat ligjore të përcaktuara në DPK. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë grupi i marrë së bashku.

### 7.4 Të drejta shtesë të Autoritetit Kontraktues

Pa krijuar kufizim për të drejtat e tjera të tij gjatë Procedurës Konkurruese, Autoriteti Kontraktues mundet që, në çdo moment përpara Dorëzimit të Ofertave pa dhënë arsye:

- të japë çdo informacion shtesë apo sqarim për të gjithë Ofertuesit e Mundshëm;
- të ndryshojë strukturën ose kohën e Procedurës Konkurruese;

Open Procurement Albania

- të shtyjë Afatin e Dorëzimit, gjatë së cilës çdo Ofertuesi të Mundshëm do t'i jepet mundësia të ndryshojë Ofertën;
- t'i përgjigjet pyetjeve të drejtuara për sqarim Autoritetit Kontraktues nga Ofertuesit e Mundshëm dhe të publikojë pyetjen dhe përgjigjen përmes Qendrës Virtuale të Dhënave;
- të refuzojë t'u përgjigjet kërkesave për informacion;
- Te pezullojë, ndërpresë apo anuloje Procedurën Konkurruese. Ofertuesit e Mundshëm nuk kanë të drejtë të ngrenë pretendime ndaj Autoritetit Kontraktues, lidhur me këto vendime.

*7.4.1 Dokumentacioni i brendshëm*

Autoriteti Kontraktues nuk është i detyruar të publikojë ndonjë dokumentacion të brendshëm (përfshirë raportet e vlerësimit apo konsultimet).

*7.4.2 Informacioni i rremë*

Çdo Ofertues i Mundshëm që jep informacion të rremë mund të përjashtohet nga Procedura Konkurruese në çdo moment. Nëse zbulohet dhënia e informacionit të rremë pas nënshkrimit të Kontratës të Koncesionit, Autoriteti Kontraktues ka të drejtën të ndërpresë/zgjidhë Kontratën e Koncesionit në përputhje me kushtet e saj.

## 7.5 Kostot

Open Procurement Albania

Çdo Ofertues i Mundshëm do të përballojë kostot dhe shpenzimet e tij në lidhje me përgatitjen dhe dorëzimin e Ofertës së tij si dhe vizitën në terren.

Koncesionari gjithashtu do të rimbursojë kostot e Autoritetit Kontraktues që lidhen me publikimin e njoftimit të kontratës si dhe shpenzimet noteriale.

## 7.6 Vizita ne terren

Një vizite e detyrueshme ne terren do te zhvillohet përgjatë segmentit rrugor parashikuar nga AK, ne ditën e pesëmbëdhjetë nga data e publikimit.

Nisja do te bëhet e organizuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Godina e re, me adrese Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1, Tirane AL) ora 9:00 a.m (me orën lokale) dhe ne fund te vizitës, pjesëmarrësit do te pajisen me një certifikate pjesëmarrje, e detyruar te paraqitet si pjese e dokumentacionit te gares.
Kujdes: Ofertuesi i mundshëm do te përballojë vetë te gjitha shpenzimet e vizitës në terren.

**7.7** Konflikti i Interesit

*7.7.1 Konflikti i Interesit*
Një konflikt interesi do të thotë çdo çështje, rrethanë, interes apo veprim tjetër që prek Ofertuesin e Mundshëm (përfshirë zyrtarët, punonjësit, agjentët dhe nënkontraktorët e Ofertuesit të Mundshëm), e cila mund të ndërhyjë në aftësinë e Ofertuesit të Mundshëm për të përmbushur me pavarësi dhe transparencë Kontratën e Koncesionit.

Një konflikt interesi mund të ndodhë në rastet kur:

- Ofertuesi i Mundshëm ose ndonjëri nga zyrtarët, punonjësit, ose nën- kontraktorët e tij ka

një marrëdhënie (profesionale, tregtare ose personale) me ndonjë individ të përfshirë në përgatitjen e Procedurës Konkurruese ose vlerësimin e Ofertave;

- Ofertuesi i Mundshëm ose ndonjëri nga zyrtarët, punonjësit, agjentët ose nën- kontraktorët e tij ka një marrëveshje apo marrëdhënie me ndonjë organizatë ose individ e cila do të ndikojë mbi zbatimin e Kontratës së Koncesionit apo ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Ofertuesit të Mundshëm dhe Autoriteti Kontraktues në lidhje me Projektin.

Në rastin kur një Ofertues i Mundshëm bëhet i vetëdijshëm rreth ndonjë konflikti interesi ai do të informojë menjëherë Autoritetin Kontraktues.

Në rast të një shfaqjeje të konfliktit të interesit, Autoriteti Kontraktues ka mundësinë që:

- të përjashtojë Ofertuesin e Mundshëm nga pjesëmarrja e mëtejshme në Procedurën Konkurruese;
- të negociojë me Ofertuesin e Mundshëm për të zgjidhur konfliktin e interesit;
- të ndërmarrë çdo veprim tjetër që konsiderohet i përshtatshëm nga Autoriteti Kontraktues.

*7.7.2 Veprime të paligjshme*

Në përputhje me legjislacionin mbi parandalimin e konfliktit të interesit dhe etikën në administratën publike, Autoriteti Kontraktues do të refuzojë çdo Ofertë të dorëzuar nga një Ofertues i Mundshëm i cili:

- ka dhënë apo synon të japë ndonjë punonjësi aktual apo të dikurshëm të Autoritetit Kontraktues një dhuratë në para apo çdo formë tjetër si një stimul për të ndikuar një veprim apo vendim gjatë Procedurës Konkurruese;
- ka një konflikt interesi të pazgjidhur apo mosmarrëveshje në lidhje me Procedurën Konkurruese.

Asnjë Ofertues i Mundshëm (përfshirë agjentët dhe përfaqësuesit e tij) nuk do të kontaktojë apo të përpiqet të kontaktojë ndonjë anëtar të Autoritetit Kontraktues, ndonjë anëtar të Komisionit të Dhënies me Koncesion, apo ndonjë anëtar ose punonjës të Qeverisë së Shqipërisë ose drejtorive, ministrive, agjencive të tyre ose organeve lokale ekzekutive, në lidhje me Procedurën Konkurruese, përveç se për procedurat e përcaktuara në këtë Dokument të Procedurës Konkurruese.

Autoriteti Kontraktues do të informojë me shkrim çdo Ofertues të Mundshëm apo çdo institucion tjetër të Qeverisë së Shqipërisë në lidhje me çdo veprim të paligjshëm dhe do të përfshijë çdo njoftim në raportin rreth Procedurës Konkurruese.

## 7.8 Pavlefshmëria e ofertës dhe dështimi i procedurës së tenderit.

Në bazë të Nenit 33 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 634, datë 1/10/2014 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale", i ndryshuar, Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë këtë Procedurë Konkurruese:

**1.** Të pavlefshme kur një ofertues:
   a) nuk ka dhënë garancitë/sigurimin e nevojshëm;
   b) nuk ka përmbushur një nga kërkesat materiale të kërkesës për propozime;
   c) ka siguruar të dhëna false të një natyre materiale në ofertën e vet.

**2.** Jo të suksesshme, kur:

Open Procurement Albania

a) asnjë nga ofertat e dorëzuara nuk i përmbush kërkesat e kërkesës për propozime;
b) autoriteti kontraktues vendos që asnjë nga ofertat e dorëzuara nuk jep zgjidhje të pranueshme financiarisht apo teknikisht;
c) Këshilli i Ministrave të Shqipërisë nuk miraton kontratën e koncesionit.

Do të konsiderohet që përmes dorëzimit të Ofertës, Ofertuesi i Mundshëm bie dakord dhe çliron Autoritetin Kontraktues, punonjësit dhe këshilltarët e tij në mënyrë të pakthyeshme, të pakushtëzuar, të plotë dhe përfundimtare nga çdo dhe të gjitha përgjegjësitë për pretendimet, humbjet, dëmet, kostot, shpenzimet apo përgjegjësitë që lidhen apo lindin në ndonjë mënyrë nga ushtrimi i ndonjë të drejte dhe/ose plotësimi i ndonjë detyrimi këtu poshtë, bazuar në dhe/ose në lidhje me si më poshtë dhe heq dorë nga çdonjëra dhe të gjitha të drejtat dhe/ose pretendimet që mund të ketë në lidhje me këtë, qoftë aktuale apo të paparashikuara, qoftë të tanishme apo të ardhshme.

### 7.9 Udhëzime për hartimin e ofertës

Dokumentet e Ofertës duhet te hartohen dhe te përfshijnë:

*a) Oferta Ligjore*

Ofertuesit e Mundshëm do të japin Formularin e Deklarimit të Ofertës (Shtojca 3), i cili përfshin, ndërmjet të tjerave, një deklaratë që konfirmon se ata pranojnë termat e Kontratës së Koncesionit siç janë hartuar. Në rast se Ofertuesi i Mundshëm është një Konsorcium dhe/ose Bashkim i Përkohshëm i shoqërive, Shtojca 3 -- Formulari i Deklarimit të Ofertës duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar i secilit anëtar të Konsorciumit dhe/ose Bashkimit te Përkohshëm te Shoqërive.

Ofertuesit e Mundshëm do të paraqesin kopje të certifikuara të vendimit të organeve Drejtuese Vendimmarrëse të Ofertuesit të Mundshëm (me noterizimin dhe legalizimin/apostilen përkatëse nëse janë shoqëri te huaja) për dorëzimin e Ofertës dhe miratimin nga Ofertuesi i Mundshëm per lidhjen dhe zbatimin e Kontratës së Koncesionit. Në rastin e një Konsorciumi, këto vendime do të kërkohen nga secili prej anëtarëve të Konsorciumit dhe/ose Bashkimit te Përkohshëm te Shoqërive.

Ofertuesit e Mundshëm do të japin një autorizim përfaqësimi i cili do të jetë i noterizuar dhe me apostile/i legalizuar (ne rast te shoqërive te huaja) siç përcaktohet në Shtojcën 7.

Ofertuesit e Mundshëm do të japin Sigurimin e Ofertës në formën e përcaktuar në Shtojcën 6 të DPK.

b) *Oferta Financiare*

Pagesa e Disponueshmërisë se Autoritetit Kontraktues;

Ofertuesit e Mundshëm do të dorëzojnë formularin e përcaktuar në Shtojcën nr. 21 “Modeli Financiar” te këtij Dokumenti të Procedurës Konkurruese, që përmban shumën e Pagesave të Disponueshmërisë të Autoritetit Kontraktues të kërkuar nga Ofertuesi i Mundshëm për gjithë kohëzgjatjen e Periudhës së Koncesionit.

c) *Modeli Financiar*

Open Procurement Albania

Ofertuesit e Mundshëm do të dorëzojnë një model financiar në përputhje me kërkesat e Shtojcës 21. Modeli financiar i Ofertuesit të Përzgjedhur i cili do hartohet ne Euro, do të auditohet dhe do të bëhet Modeli Financiar Referencë pas rishikimit dhe miratimit nga Autoriteti Kontraktues. Dokumenti i formatit bazë është publikuar dhe duhet të plotesohet duke qene pjesë të modelit financiar të Ofertuesve.

Për qëllimin e këmbimit Euro/Lek në modelet e tyre financiare, Ofertuesit e Mundshëm do të përdorin Kursin Zyrtar të Këmbimit Euro /Lek të shfaqur në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë në datën e publikimit të kësaj procedure.

*d) Oferta Teknike*

Secili Ofertues duhet të hartojë Projekt-Ide /propozimin (të Aksit Rrugor Porti i Jahteve - Bypass Orikum - Dukat (Ura e Shën Elizës)), Metodologjinë dhe Grafikun për realizimin e Punimeve si dhe të hartojë Planin/Manualin për Shërbimet e Mirëmbajtjes, siç specifikohet më poshtë:

Secili ofertues gjate hartimit te projekt-Idesë/propozimit lidhur me metodologjinë e ndërtimit referuar ne planimetri/vizatime/profile *tip* e dhënë bashkëlidhur, do te paraqesë pa ulur cilësinë dhe standartet e kërkuara, por pa u kufizuar, ne propozimin e një oferte teknike duke konsideruar edhe modifikim te elementeve me qellim uljen e kostos ose përmirësim/rritje te standartit.

e) *Hartimi i Projekt-Idesë* (Konceptual) sipas Kategorisë se Rrugës, në përputhje me aktet ligjore:

- Ligji Nr 8378/1998:”Për Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr 8308/1998: ”Për Transportin Rrugor”;
- Ligji Nr 10431dt 09.06.2011:”Për mbrojtjen eMjedisit”;
- Ligji Nr 10440 dt 07.07.2011;”Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe aktet nënligjorë që rrjedhin prej tij;
- Ligjin Nr. 9048. dt. 07.04.2003: "Për trashëgiminë kulturore";
- Ligj Nr. 107/2014:” Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligj Nr.9734, dt 14.5.2007:” Për turizmin”;
- Ligj Nr.8897, dt 16.5.2002:” Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”;
- Ligj Nr. 8906, dt 6.6.2002: “Për zonat e mbrojtura”dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.
- Ligjin Nr.9142, dt 16.10.2003:”Për aderimin në Konventën e shënjave dhe sinjaleve rrugore Vjenë, 8 Nëntor 1968 të Republikës së Shqipërisë :”
- VKM Nr.1214, dt 03.09.2008: “Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të Transportit”;
- VKM Nr.897, dt 21.12.2011: “Për miratimin e rregullave të shpalljes së zonave të veçanta të ruajtjes”;
- VKM Nr 153/2000:”Për aplikimin e Rregullores dhe implementimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë;
- Udhëzim i MPPT Nr.9, dt 3.07.2012 “Mbi auditimin dhe inspektimin e sigurisë rrugore” dhe “Udhëzuesi i Auditimit të sigurisë rrugore”;
- VKM Nr 125, dt 23.2.2011: “Për zbatimin e objektivave për përmirësimin e sigurisë rrugore”

Open Procurement Albania

- VKM Nr.722, datë 19.11.1998 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”(i ndyshuar)
- VKM Nr 628, dt 15.07.2015: “Mbi rregullat teknike te projektimit dhe zbatimit te rrugeve”.
- VKM Nr 629, dt 15.07.2015: “Mbi miratimin e manualeve teknike të çmimeve për punimet e ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”

f) *Punimet e Ndërtimit*, të përfshijnë minimalisht seksionet dhe përmbajtjen e mëposhtme:

- Metodologjinë e Realizimit të punimeve ndërtimore sipas projekt-idesë konceptuale/propozimit të hartuar nga ofertuesit e mundshëm.
- Grafikun e Punimeve sipas projekt-idesë konceptuale të hartuar nga ofertuesi i mundshëm.
- Kapacitetin e kantierit me makineri dhe pajisje;

g) *Mbrojtja e shëndetit dhe jetës*: politika e Koncesionarit për mbrojtjen e shëndetit dhe të jetës, organizimin dhe përgjegjësitë, emërimin e një zyre dhe nëpunësi sigurie (nëpunësi për parandalimin e aksidenteve), trajnime të stafit, kërkesat për ndërtim të parrezikshëm, procedurat e vlerësimit dhe menaxhimit të riskut, masa për magazinimin dhe trajtimin e materialeve të rrezikshme, objektet e shërbimeve mjekësore dhe të kujdesit social në terren, procedurat për situatat e jashtëzakonshme, menaxhimin e trafikut dhe kufizimet e shpejtësisë.

- Menaxhimi mjedisor dhe social: (i) politika mjedisore, (ii) procedurat e zbutjes së efekteve negative, (iii) procedurat e monitorimit, (iv) procedurat e shqyrtimit dhe auditimit, dhe (v) procedurat për konsultimin dhe informimin e publikut.

gj) Planet/Manualet për Shërbimet e Mirëmbajtjes, minimalisht, duhet të përfshijë seksionet dhe përmbajtjen e mëposhtme:

- Manual të kontrollit të cilësisë për dhe mirëmbajtjen, ku trajtohen; Organizimi dhe përgjegjësitë e propozuara për inspektimin, marrjen e kampioneve dhe testimin e materialeve dhe punimeve për mirëmbajtjen e Rrugës Porti i Jahteve - Bypass Orikum - Dukat (Ura e Shën Elizës).

h) Manuali i mbrojtjes së shëndetit dhe jetës, që përfshin:

- politikën e Koncesionarit për mbrojtjen e shëndetit dhe të jetës,
- organizimin dhe përgjegjësitë,
- emërimin e nëpunësit te sigurie (nëpunësi për parandalimin e aksidenteve),
- trajnime të stafit,
- kërkesat për ndërtim të sigurte,
- procedurat e vlerësimit dhe menaxhimit të riskut,
- masa për magazinimin dhe trajtimin e materialeve të rrezikshme,
- objektet e shërbimeve mjekësore dhe të kujdesit social në terren,
- procedurat për situatat e jashtëzakonshme,
- menaxhimin e trafikut dhe kufizimet e shpejtësisë.

Open Procurement Albania

i) Manuali i mirëmbajtjes me përmbajtje si me poshtë:

- Procedurat e bashkërendimit në lidhje me mirëmbajtjen e Rrugës Porti i Jahteve - Bypass Orikum - Dukat (Ura e Shën Elizës),
- Procedurat e hollësishme për mirëmbajtjen e Rrugës Porti i Jahteve - Bypass Orikum - Dukat (Ura e Shën Elizës), në veçanti në lidhje me
  - Menaxhimin e trafikut dhe kufizimet për trafikun permanent dhe të përkohshëm;
  - Procedurat për situatat e jashtëzakonshme, përfshirë mbylljen e korsive në rast situate të jashtëzakonshme ose emergjence te ndryshme (incidente, aksidente por pa u kufizuar). (Plani në kundërpërgjigje të situatave të jashtëzakonshme);
  - Operimin pa rrezik të Rrugës Porti i Jahteve - Bypass Orikum - Dukat (Ura e Shën Elizës) dhe sigurinë e Përdoruesve, punëmarrësve të Koncesionarit dhe vizitorëve të lejuar në Rrugën Porti i Jahteve - Bypass Orikum - Dukat (Ura e Shën Elizës) në përputhje me Manualin e mbrojtjes se shëndetit dhe jetës;
  - Hollësi për kërkesat për raportim te rregullt,
- Udhëzimet për mirëmbajtjen e Rrugës Porti i Jahteve - Bypass Orikum - Dukat (Ura e Shën Elizës), përfshirë komponentët strukturorë dhe jo strukturorë, impiantet dhe pajisjet;
- Procedurën për planifikimin e punimeve për mirëmbajtjen rutine dhe riparimet e nevojshme, përfshirë edhe mbylljet e korsive të planifikuara për këto punime

j) Organizimi: një grafik organizativ të Ofertuesit të mundshëm, përfshirë njësitë kryesore administrative (stafi tekniko-organizativ), një përshkrim të shkurtër të pozicioneve kyç drejtuese dhe teknike, emrat dhe të dhënat e përvojës së personelit kyç, dhe numrat e përafërt totalë të personelit në njësitë kryesore organizative.

Open Procurement Albania

k) *Kontrolli i Trafikut*: një plan i përgjithshëm për kontrollin e trafikut dhe ndihmës për përdoruesit, përfshirë trajtimin e emergjencave dhe mbylljet e korsive, përllogaritjet e personelit dhe çdo mase tjetër te nevojshme.

l) *Mirëmbajtja*: plan i përgjithshëm për aktivitetet e inspektimeve dhe riparimeve; mirëmbajtjes rutinë, përfshirë ato për mirëmbajtjen dimërore, përfshirë dhe përshkrime të shkurtra të metodave dhe teknikave për tu përdorur, sistemet e planifikimit, kontrollit dhe raportimit, monitorimi dhe vlerësimi i performancës, përllogaritja e kërkesave për personel dhe burime të tjera.

ll) *Sigurimi i Cilësisë*: një përshkrim të qasjes së propozuar për kontrollin e cilësisë, përfshirë procedurat, metodat, personeli dhe burime të tjera për të siguruar cilësinë e hartimit të projektit të zbatimit, të punimeve të ndërtimit dhe shërbimet e mirëmbajtjes në përputhje me kërkesat kontraktuale, përfshirë aspektet e tyre mjedisore, shëndetësore dhe të sigurisë. Sistemet e propozuara të plotësojnë standardet përkatëse ISO, edhe nëse certifikimi ISO nuk është një kërkesë.

m) *Mbrojtja e shëndetit dhe jetës*: politika e Koncesionari për mbrojtjen e shëndetit dhe të jetës, organizimin dhe përgjegjësitë, emërimin e një nëpunësi sigurie (nëpunësi për parandalimin e aksidenteve), trajnime të stafit, kërkesat për ndërtim te parrezikshëm, procedurat e vlerësimit dhe menaxhimit te riskut, masa për magazinimin dhe trajtimin e

materialeve të rrezikshme, objektet e shërbimeve mjekësore dhe të kujdesit social në terren, procedurat për situatat e jashtëzakonshme, menaxhimin e trafikut dhe kufizimet e shpejtësisë.

n) *Menaxhimi mjedisor dhe social*: (i) politika mjedisore, (ii) procedurat e zbutjes së efekteve negative, (iii) procedurat e monitorimit, (iv) procedurat e shqyrtimit dhe auditimit, dhe (v) procedurat për konsultimin dhe informimin e publikut.

## 8. AFATI KOHOR DHE VENDI PËR DORËZIMIN E OFERTAVE

**8.1** Afati kohor për paraqitjen e ofertave skadon me 20 Shtator 2018 ora 12.00

Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre mund të jenë të pranishëm në hapjen e kërkesave.

Informacioni qe komunikohet gjatë hapjes publike te ofertave ose kerkesave te paraqitura per sqarime, që paraqiten me mjete elektronike duhet t'i komunikohet te gjithë atyre Operatoreve Ekonomikë që kane dorëzuar oferten, në bazë te përcaktimeve te bëra ne DPK.

**8.2** Ofertat duhet të dorëzohen në adresën : www.app.gov.al

## 9. DORËZIMI I OFERTAVE (LIGJORE / TEKNIKE / FINANCIARE)

**9.1** Ofertat duhet të dorëzohen në adresën e mëposhtme: www.app.gov.al

**9.2** Oferta duhet të përmbajë, dokumentet e mëposhtme:

- Formulari i Ofertës, plotësuar në përputhje me modelin e bashkangjitur si Shtojcat 4 e DSK/PPP.
- Formulari i Sigurimit të ofertës, duhet te plotësohet në përputhje me modelin e bashkangjitur si Shtojcat 6 e DSK/PPP.
- Planin e biznesit
- Dokumentet që lidhen me objektin e koncesionit/partneritetit publik privat (skica, projekte, etj.)
- Vendimi i organeve vendimmarrëse
- Prokura e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomik në favor të përfaqësuesve (nëse përfaqësuesi nuk është përcaktuar shprehimisht në marrëveshjen e krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomik).
- Marrëveshja e bashkimit të operatorëve ekonomik (nëse do te paraqiten te tille).
- Dokumentacionin ligjor, përmbushjen e kërkesave tekniko-ekonomike, ofertën teknike si dhe ofertën financiare sipas përcaktimeve të bëra në DPK (shtojca 9).

Komisioni vlerëson dokumentet e mësipërme të paraqitura nga operatorët ekonomikë për përputhshmërinë e tyre me përcaktimet e DPK.

### 9.3 Sigurimi i Ofertës

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 634, datë 1/10/2014 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale", i ndryshuar, secili Ofertues i Mundshëm do të ofrojë një Sigurim Oferte në shumën 2% (dy%) të vlerës së

Open Procurement Albania

Projektit, te ofruar sipas percaktimit te pikes 2.10.

Sigurimi i Ofertës do të jetë një garanci e lëshuar nga një bankë. Sigurimi i Ofertës, në formën e formularit të përcaktuar në Shtojcën 6 (gjashtë) do të jetë e vlefshme deri në 180 dite pas Afatit të Dorëzimit.

Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të kërkojë zgjatjen e vlefshmërisë të Sigurimit të Ofertës të Ofertuesit të Suksesshëm deri në datën e dorëzimit të sigurimit të kontratës.

Sigurimi i Ofertës do të dorëzohet së bashku me Ofertën jo më vonë se Afati i Dorëzimit. Ofertat e dorëzuara pa një Sigurim Oferte do të refuzohen nga Komisioni i Dhënies me Koncesion dhe Autoriteti Kontraktues.

Sigurimi i Ofertës që mbulon një Ofertë të dorëzuar nga një Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive dhe/ose Konsorcium do të jetë në lidhje me të gjithë anëtarët e bashkimit te përkohshëm dhe/ose konsorciumit si i tërë dhe në emër të secilit anëtar të konsorciumit.

Autoriteti Kontraktues do ta kthejë Sigurimin e Ofertës të Ofertuesve të Mundshëm të pasuksesshëm sa më shpejt të jetë e mundur por jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike pas skadimit të periudhës së vlefshmërisë të Sigurimit të Ofertës

Autoriteti Kontraktues do ta kthejë Sigurimin e Ofertës të ofertuesit të suksesshëm pas marrjes së Garancisë së Kontratës.

Sigurimi i Ofertës mund të mbahet nga Autoriteti Kontraktues vetëm në rrethanat e mëposhtme:

- një Ofertues i Mundshëm e tërheq Ofertën e tij gjatë periudhës së vlefshmërisë së Ofertës;
- Ofertuesi i Përzgjedhur nuk ofron Garancinë e Kontratës dhe/ose nuk nënshkruan Kontratën e Koncesionit brenda afateve të specifikuar në Njoftimin e Ofertuesit Fitues.
- një Ofertues i Mundshëm ka ofruar apo është përpjekur të ofrojë çdo lloj shpërblimi për punonjësit e Autoritetit Kontraktues të cilët kanë lidhje me Projektin;
- një Ofertues i Mundshëm ka bërë deklarime të pavërteta në ofertën e tij;
- Ofertuesi i Përzgjedhur nuk bën pagesat në përputhje me kërkesat brenda periudhës të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

**9.4** Sigurimi i Ofertës duhet të dorëzohet sipas përcaktimeve të bëra në DPK.

**9.5** Formulari i sigurimit te ofertës duhet të nënshkruhet nga lëshuesi (Banka) dhe duhet te dorëzohet para hapjes se ofertave përndryshe oferta do të refuzohet.

**9.6** Sigurimi i ofertës duhet te jetë i vlefshëm përgjatë gjithë periudhës se vlefshmërisë se ofertës. Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë rast pas rasti zgjatjen e periudhës se vlefshmërisë së Sigurimit te Ofertës. Autoriteti Kontraktues ia rikthen ofertuesve sigurimin përkatës te ofertës brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

**9.7** Vendimi i organeve drejtuese te shoqërisë, duhet te përmbajë minimalisht:

a) Konfirmimin për pjesëmarrje në procedurën konkurruese dhe dorëzimin e ofertës financiare:
b) Autorizimin me fuqi te plote te personit që paraqet dhe nënshkruan ofertën.

**Periudha e Vlefshmërisë se Ofertës**

Open Procurement Albania

**9.8** Ofertat duhet te jenë të vlefshme për 180 dite që nga momenti i përfundimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertës. Periudha e vlefshmërisë se ofertave fillon qe nga momenti i skadimit te afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Për sa kohe nuk ka skaduar afati kohor për vlefshmërisë e ofertave. Autoriteti Kontraktues mund t'i kërkoje Ofertuesit me shkrim te zgjasë periudhën e vlefshmërisë deri ne një date te caktuar. Ofertuesi qe bie dakord te zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës dhe te njoftoje Autoritetin Kontraktues me shkrim, duhet te zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës dhe te paraqesë një sigurim oferte te zgjatur. Oferta nuk mund te modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk arrin t'i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti Kontraktues lidhur me zgjatjen e periudhës se vlefshmërisë se ofertës, ose nuk bën zgjatjen e periudhës se vlefshmërisë, ose nuk arrin te paraqesë një sigurim te zgjatur te ofertës, atëherë do te konsiderohet se Ofertuesi e ka refuzuar kërkesën e Autoritetit Kontraktues. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues do të refuzoje ofertën.

## 9.9 Veprimet e kundërligjshme

Ne përputhje me legjislacionin për parandalimin e konfliktit te interesit, dhe etikën ne administratën publike, Autoriteti Kontraktues e refuzon një oferte, nëse Ofertuesi qe e ka paraqitur atë:

i) i ka dhënë ose përgatitet t'i japë një punonjësi aktual ose te mëparshëm te Autoritetit Kontraktues një dhurate ne para ose jo, si një përpjekje për të ndikuar një veprim ose vendim ose rrjedhën e procedurës së konkurrimit: dhe ose;
ii) është ne kushtet e konfliktit të interesit në këtë procedurë, si p.sh. - një ofertues kontrollohet nga një person fizik ose juridik, qe është ngarkuar nga Autoriteti Kontraktues të japë shërbime këshilluese gjate përgatitjes se projekteve specifikimeve ose dokumenteve të tjerë lidhur me procedurën konkurruese, apo ka lidhje me anëtarë të Komisionit të Vlerësimit te Ofertave.
iii) ka dorëzuar dokumente/informacione të rreme, që lidhen me kërkesat e paraqitura në Dokumentet Standarde të Procedurës Konkurruese, Autoriteti Kontraktues e informon me shkrim ofertuesin dhe Agjencinë e Prokurimit Publik për refuzimin e ofertës, si dhe për arsyet e këtij refuzimi, dhe bën shënimin përkatës në raportin për procedurën e konkurrimit.

## 9.10 Konfidencialiteti

### *9.10.1 Konfidencialiteti i Ofertës*

Çdo material, dokument, akt apo deklaratë e shkruar që përmban ndonjë informacion do të konsiderohet konfidencial nëse ai:

- është sekret për vetë natyrën e tij;
- përcaktohet që është konfidencial.

Pavarësisht sa me sipër, Ofertuesit e Mundshëm duhet të identifikojnë qartësisht çdo dokument apo informacion që ata dëshirojnë të mbetet konfidencial duke plotësuar formularin siç jepet në Shtojcën 7 (shtatë) “Lista e Informacionit Konfidencial”.

Çdo diskutim, komunikim apo negocim ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Ofertuesit të Mundshëm mbetet konfidencial. Nëse nuk kërkohet nga ligji, vendimi i gjykatës apo kërkesa për propozim, asnjë palë nuk mund të publikojë informacion teknik, informacion mbi çmimet

Open Procurement Albania

apo ndonjë informacion tjetër të lidhur me Procedurën Konkurruese pa miratim paraprak.

Autoriteti Kontraktues nuk do të shkele detyrimet për të ruajtur konfidencialitetin në lidhje me një Ofertues të Mundshëm në rastet kur të dhënat:

- u janë dhënë nga Autoriteti Kontraktues punonjësve, këshilltarëve apo nënkontraktorëve te tij vetëm në lidhje me Procedurën Konkurruese apo me qëllim përgatitjen apo menaxhimin e ndonjë kontrate.
- u janë dhënë personelit të Autoritetit Kontraktues për të mundësuar menaxhimin dhe kontrollin efektiv të Procedurës Konkurruese;
- janë nxjerrë nga Komisioni i Dhënies me Koncesion për të mundësuar vlerësimin e Ofertave;
- janë nxjerrë nga Autoriteti Kontraktues si përgjigje ndaj një kërkese të një komisioni të Kuvendit të Shqipërisë;
- janë nxjerrë nga Autoriteti Kontraktues brenda Qeverisë së Shqipërisë ose për një Drejtori ose Agjenci Qeveritare në përputhje me interesat legjitime të Qeverisë së Shqipërisë dhe Autoritetit Kontraktues;

*9.10.2 Konfidencialiteti i informacionit të Autoritetit Kontraktues*

Informacioni i ofruar nga Autoriteti Kontraktues për Ofertuesit e Mundshëm do të trajtohet si konfidencial nga Ofertuesi i Mundshëm, përfaqësuesit dhe konsulentët e tij.

Ofertuesit duhet të garantojnë që punëdhënësit, nënkontraktorët dhe konsulentët e tyre nuk do të publikojnë apo komunikojnë të dhëna të marra gjatë përgatitjes së Ofertës nga Autoriteti Kontraktues, Komisioni i Dhënies me Koncesion apo ndonjë palë e tretë përveç se kur lejohet nga Autoriteti Kontraktues.

Open Procurement Albania

Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë që i gjithë informacioni i shkruar (qoftë konfidencial ose jo dhe pavarësisht mënyrës se si ky informacion u është dhënë Ofertuesve të Mundshëm) i dhënë Ofertuesve të Mundshëm:

- t'i kthehet Autoritetit Kontraktues - rast në të cilin i gjithë ky informacion do të kthehet menjëherë nga Ofertuesi i Mundshëm në adresën e identifikuar nga Autoriteti Kontraktues; ose

- të shkatërrohet nga Ofertuesi i Mundshëm - rast në të cilin Ofertuesve të Mundshëm do tu kërkohet të shkatërrojnë menjëherë çdo informacion të tillë dhe t'i ofrojnë Autoritetit Kontraktues provë me shkrim të këtij shkatërrimi.

*9.10.3 Përdorimi i dokumenteve të Ofertës*

Të gjitha Ofertat bëhen pronë e Autoritetit Kontraktues.

Pavarësisht sa më sipër dhe pa paragjykuar ndonjë marrëveshje të mëpasshme të nënshkruar ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe ndonjë Ofertuesi të Mundshëm, pronësia e të drejtave të pronësisë intelektuale në lidhje me informacionin e gjendur në Ofertë mbeten të pandryshuara.

Autoriteti Kontraktues mund të përdorë të dhënat që përmbahen në ndonjë propozim ose të dhënat e ofruara nga një Ofertues i Mundshëm për qëllimet e Procedurës Konkurruese (përfshirë përgatitjen ose menaxhimin e çdo kontrate apo marrëveshjeje).

Autoriteti Kontraktues do të trajtojë Ofertuesit e Mundshëm në mënyrë të barabartë gjatë Procedurës Konkurruese në lidhje me konfidencialitetin dhe informacionin e ofruar prej tyre.

### 9.11 Referenca e qartë dhe përputhshmëria

Ofertuesit e Mundshëm duhet të përfshijnë në çdo dokument një referencë të qartë në faqen dhe paragrafin përkatës të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.

Çdo Ofertë duhet të jetë në përputhje me të gjithë kërkesat e Dokumenteve të Procedurës Konkurruese

### 9.12 Siguria, integriteti dhe kontrolle të tjerë

Autoriteti Kontraktues mund të kryejë një hetim të arsyeshëm apo procedurë të ngjashme që e konsideron të nevojshme për të shqyrtuar integritetin dhe financimin që lidhet me një Ofertë ose Ofertuesit.

Ofertuesi të cilit i kërkohet, do të ofrojë menjëherë çdo informacion ose ndihmë nga Autoriteti Kontraktues me qëllim që çdo hetim i nevojshëm të kryhet. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të përjashtojë çdo Ofertë nga vlerësimi i mëtejshëm nëse një Ofertues nuk jep informacionin e kërkuar ose ndihmë të arsyeshme Autoritetit Kontraktues.

Komisioni i Dhënies me Koncesion do të ketë të drejtë t'iu bëjë pyetje Ofertuesve në mënyrë të pavarur në lidhje me çdo çështje që ai e konsideron të rëndësishme për vlerësimin e Ofertave.

### 9.13 Nënkontraktimi

Open Procurement Albania

Autoriteti kontraktues lejon nënkontraktimin për realizimin e një pjese të kontratës. Në asnjë rast, kontraktorët nuk mund t'ua transferojnë kontratën palëve të treta.

Me dorëzimin e ofertave, ofertuesit duhet të deklarojnë punët/shërbimet/mallrat ose një pjesë të tyre që ata kanë qëllim të nënkontraktojnë, në rast se shpallen fitues, si dhe emrin e nënkontraktorit.

Përpara lidhjes së kontratës, ofertuesi i shpallur fitues duhet t'i dorëzojë autoritetit kontraktues një kopje të noterizuar të marrëveshjes së nënkontraktimit dhe dëshminë e kualifikimeve e të kërkesave teknike të nënkontraktorit, në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktor të mund të miratojë nënkontraktimin.

Komisioni s'kualifikon nga procedura konkurruese kur ka të dhëna se janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjykate të formës së prerë, për ndonjë nga veprat e mëposhtme:

a) pjesëmarrje në organizatë kriminale;
b) korrupsion;
c) mashtrim;
ç) pastrim parash, vepra për qëllime terroriste;
d) falsifikim.

Çdo kandidat ose ofertues s'kualifikohet nga një procedurë konkurruese në rastet kur:

a. ka falimentuar dhe kapitalet e tij janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit;

b. është subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;
c. është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
d. nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;
dh. nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;
e. është fajtor për dhënie të informacioneve të rreme, ose nuk ka pranuar t'i japë këto informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre.

Komisioni pranon si prova të mjaftueshme, që shmangin përjashtimin e kandidatëve apo ofertuesve për rastet e parashikuara në pikat e mësipërme, këto dokumente:

a. vërtetim nga dosja gjyqësore, ose në rast se nuk sigurohet kjo, një dokument të njëvlershëm, të lëshuar nga një autoritet kompetent, gjyqësor apo administrativ, që vërteton se nuk ekzistojnë çështjet e përmendura.
b. një vërtetim të lëshuar nga organi kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë çështjet e përmendura/

Nënkontraktorët duhet te zotërojnë kualifikimet teknike për pjesën e punës e të shërbimeve që do të kryejë ose për mallrat që do të furnizojë.

## 10. VLERËSIMI I PROPOZIMEVE

Open Procurement Albania

Ofertat e Ofertuesve do të vlerësohen nga Komisioni i Dhënies me Koncesion. Komisioni bën identifikimin e ofertuesve dhe hapjen e ofertave të dorëzuara në faqen e internetit të APP, pas mbarimit të afatit për dorëzimin e ofertave.

Ofertat do të vlerësohen në përputhje me kriteret e përcaktuara në Shtojcën 9 dhe DPK. Në rastin kur dorëzohet vetëm një ofertë sipas kërkesave, Komisioni i Dhënies me Koncesion gjithsesi do të shqyrtoje Ofertat në përputhje me këto Dokumente të Procedurës Konkurruese.

Komisioni i Dhënies me Koncesion është ngritur bazuar në urdhrin e titullarit te Autoritetit Kontraktues në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 634, datë 1/10/2014 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale", i ndryshuar. Komisioni i Dhënies me Koncesion pas vlerësimit te ofertave dhe klasifikimit te tyre do të përgatisë një raport përmbledhës për Titullarin e Autoritetit Kontraktues në fund të procesit të klasifikimit te tyre.

Afati në dispozicion për Autoritetin Kontraktues për nxjerrjen e rezultateve te klasifikimit dhe renditjes se ofertave, do të jetë jo më shume se 60 ditë.

## 11. KRITERET E KUALIFIKIMIT DHE VLERËSIMIT

### 11.1. Kriteret e Kualifikimit

Ofertat do të Kualifikohen referuar kritereve Ligjore, Teknike dhe Financiare të përcaktuara në Dokumentet e Procedurës Konkurruese:

Ofertat do të Kualifikohen në një bazë Kalon/ Ngel.

Komisioni do të vlerësojë vetëm Ofertat që plotësojnë kriteret e kualifikimit.

### 11.2 Vlerësimi i ofertave

Vleresimi i ofertave do te kryhet sipas kritereve te vlerësimit (shtojca 9). Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe Autoriteti Kontraktues rezervojnë të drejtën të përjashtojnë një Ofertë nga vlerësimi nëse gjejnë që Oferta është e paplotë, nuk përputhet me Kërkesat e Procedurës Konkurruese, ose eshte vleresuar me minimumin e pikeve teknike sipas percaktimit ne keto Dokumenta.

Ofertuesi që ka marrë më shumë pikë nga vlerësimi i ofertave do të ftohet për negociata dhe lidhjen e kontratës.

### 11.3 Korrigjimi i gabimeve dhe pjesët e hequra.

Autoriteti Kontraktues korrigjon ato gabime në ofertë/propozim, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të ofertave/propozimeve. Autoriteti Kontraktues njofton Ofertuesin në fjalë me një njoftim me shkrim/elektronik mbi çdo korrigjim të tillë dhe mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit, me kusht që Ofertuesi t'a ketë miratuar këtë komunikim që i është bërë. Nëse Ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë oferta/propozimi do të refuzohet, duke i'a konfiskuar sigurimin e ofertës.

Gabimet në llogaritjen e ofertës do të korrigjohen nga Autoriteti Kontraktues, sipas shembujve të mëposhtme:

a) në rast se ka mospërputhje ndërmjet shumave të shprehura në shifra dhe atyre në fjalë, atëherë do të kenë përparësi shumat e shprehura në fjalë, me përjashtim të rasteve kur shuma në fjalë lidhet me një gabim aritmetik,
b) nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të ketë përparësi çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korrigjohet shuma në total,
c) nëse ka një gabim në një shumë total, që korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nën totalëve, atëherë do të ketë përparësi nën totali dhe totali duhet të korrigjohet

Shumat e korrigjuara ne këtë mënyrë janë te detyrueshme për ofertuesin. Nëse ofertuesi nuk i pranon ato, atëherë oferta e tij do ta refuzohet dhe do t'i mbahet sigurimi i ofertës. Refuzimi i korrigjimeve te gabimeve do të konsiderohet nga Autoriteti Kontraktues si tërheqje e ofertës. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute te te gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më ta ulëta se 2% e vlerës së ofertës financiare të ofruar.

## 12. PROCEDURA E ANKIMIMIT

Një Ofertues mund të kërkojë një rishikim administrativ të procesit të vlerësimit nëse ai konsideron që një veprim i marrë nga Komisioni i Dhënies me Koncesion apo Autoriteti Kontraktues është në kundërshtim me dispozitat e Legjislacionit të Koncesioneve apo legjislacion tjetër të zbatueshëm.

Në bazë të Nenit 32 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 634, datë 1/10/2014 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale", i ndryshuar:

12.1 Një ofertues ka të drejtë të kërkojë një rishikim administrativ të procesit të vlerësimit të ofertave nëse mendon se një veprim i ndërmarrë nga Komisioni i koncesionit/partneritetit publik privat apo autoriteti kontraktues është në kundërshtim me dispozitat e këtij vendimi.
12.2 Një ofertues ka të drejtën të ankimojë në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve kalendarike nga data e publikimit të ofertuesit fitues dhe të renditjes së ofertuesve nga autoriteti kontraktues.
12.3 Çdo ankimim në Komisionin e Prokurimit Publik do të bëhet në formën e duhur duke treguar emrin dhe adresën e pretenduesit, referencën e procedurës përkatëse, bazën ligjore dhe një përshkrim të shkeljes.
12.4 Çdo ankimim do të shoqërohet me një pagesë paraprake prej 10% të vlerës së sigurimit të ofertës. Në rastin kur kjo pagesë paraprake nuk kryhet, Komisioni i Prokurimit Publik mund të refuzojë të fillojë investigimin administrative. Pagesa paraprake do t'i kthehet pretenduesit nëse ankimimi pranohet. Nëse ankimimi nuk është i suksesshëm, pagesa paraprake do të mbahet nga qeveria e Shqipërisë në llogari të buxhetit të shtetit.
12.5 Pas marrjes së ankimimit, Komisioni i Prokurimit Publik do të marrë një vendim për ta pezulluar ose jo procedurën e tenderit me qëllim që të fillohen procedurat e investigimit administrativ dhe do të njoftojë autoritetin kontraktues brenda 7 ditëve kalendarike.
12.6 Komisioni i Prokurimit Publik nuk do të pezullojë procedurën e tenderit nëse:
   b) shqyrtimi paraprak i ankimimit vendos që nuk është i rregullt nga ana ligjore; ose
   c) pezullimi është kundër interesit publik.
12.7 Para hyrjes në fazën e kontratës me koncesion, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë të:
   a) shfuqizojë plotësisht apo pjesërisht vendimet apo aktet e autoritetit kontraktues;
   b) urdhërojë autoritetin kontraktues që të rregullojë shkeljet përpara se të vazhdohet më tej me procedurën e tenderit.
12.8 Komisioni i Prokurimit Publik do të marrë vendimin brenda 30 ditëve kalendarike nga marrja e ankimimit dhe do të njoftojë pretenduesin dhe autoritetin kontraktues për vendimin. Pretenduesi ka të drejtë të apelojë vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik mbi baza administrative në një gjykatë kompetente brenda 30 ditëve kalendarike nga shpallja e vendimit. Procedura e tenderit nuk do të pezullohet gjatë kohës që apelimi shqyrtohet nga gjykata.

Open Procurement Albania

## 13. NËNSHKRIMI I KONTRATËS

Autoriteti Kontraktues njofton Ofertuesin, oferta e ta cilit është përzgjedhur si me e mira, përmes dërgimit të njoftimit të shpalljes fitues, siç parashikohet në Shtojcën 15. Një kopje e këtij njoftimi publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, siç kërkohet në Shtojcën 18.

**Sigurimi i kontratës:** Autoriteti Kontraktues kërkon sigurim për ekzekutimin e kontratës. Shuma e sigurimit të kontratës në secilin vit kontraktual do të jetë 10% e vleres se punimeve ndertimore te parashikuara per ate vit, bazuar ne projektin e Zbatimit. Formulari i Sigurimit të Kontratës që është i bashkangjitur si Shtojca 19 e DPK, duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet para nënshkrimit të kontratës.
Sigurimi për ekzekutimin e kontratës që do të dorëzohet, duhet të jetë në formën e një garancie bankare të pakushtëzuar.
Në përputhje me Shtojcën 18, pas nënshkrimit të kontratës, Autoriteti Kontraktues dërgon një njoftim për Publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

### 13.1. Nënshkrimi i Kontratës së Koncesionit

*13.1.1.* Nuk do të ketë bisedime ndërmjet ofertuesit fitues dhe autoritetit kontraktues në lidhje me termat materialë të kontratës së koncesionit, me përjashtim të rasteve kur këta terma

specifikohen nga autoriteti kontraktues si të negociueshëm në kërkesën për propozime para afatit përfundimtar të dorëzimit të kontratës.

*13.1.2.* Kontrata e Koncesionit do të amendohet aq sa kërkohet me qëllim që: (i) të pasqyrojë Ofertën e Ofertuesit të Përzgjedhur dhe amendimet e kërkuara për të trajtuar ndryshimet pasuese, (ii) të plotësojë çdo boshllëk; (iii) të korrigjojë gabimet, harresat dhe mosveprimet.

*13.1.3.* Pas plotësimit të procedurës së vlerësimit dhe njoftimit të caktimit të Ofertuesit të Përzgjedhur, Autoriteti Kontraktues cakton një afat për ekzekutimin e Kontratës së Koncesionit që është parashikuar të jetë jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike nga nxjerrja e vendimit në fjalë. Ky afat mund të zgjatet sipas gjykimit dhe me vendim të Autoritetit Kontraktues.

*13.1.4.* Ofertuesi i Përzgjedhur do të angazhohet në dorëzimin e Ofertës së tij që në rast se caktohet si Ofertues i Përzgjedhur, do të përfshijë një Subjekt për Qëllime të Veçanta ("SPV") në përputhje me legjislacionin shqiptar për tu miratuar nga Autoriteti Kontraktues, për zbatimin e Projektit objekt koncesioni/PPP, që do të lidhë një marrëveshje për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve në përputhje me legjislacionin shqiptar me Ofertuesin e Përzgjedhur në lidhje me Kontratën e Koncesionit dhe do të marrë të gjithë të drejtat dhe detyrimet e Ofertuesit të Përzgjedhur ashtu sikur SPV të kishte qenë fillimisht Ofertuesi i Përzgjedhur dhe të kishte lidhur Kontratën e Koncesionit.

**13.2. Negociatat e pasuksesshme me Ofertuesin e parë të Përzgjedhur**

*13.2.1.* Në bazë të Nenit 34 paragrafi 4, të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr.634, datë 1/10/2014, i ndryshuar, në rastet kur Autoriteti Kontraktues vendos që negociatat me Ofertuesin e Përzgjedhur të parë nuk do të përmbyllen me nënshkrimin e Kontratës së Koncesionit, atëherë Autoriteti Kontraktues mund të ftojë në negociata Ofertuesin e kualifikuar të renditur të dytin, dhe nëse dështon të arrijë një marrëveshje edhe me Ofertuesin e kualifikuar të renditur të dytin, atëherë fton Ofertuesin e kualifikuar të renditur të tretë e kështu me radhë.

*13.2.2.* Autoriteti Kontraktues mundet që në diskrecion absolut të refuzojë të hyjë në negociata me ndonjërin apo të gjithë Ofertuesit e kualifikuar të mbetur në rastin kur negociatat dështojnë me Ofertuesin e Përzgjedhur të parë dhe Ofertuesi i Përzgjedhur i parë nuk ekzekuton Kontratën e Koncesionit.

*13.2.3.* Kontrata e Koncesionit/ppp do të hyjë në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave.

Open Procurement Albania

**Shtojca 1 (e pa aplikueshme për procedurën e hapur)**

**FORMULAR PER PARAQITJEN E KERKESES PER PARAKUALIFIKIM**

Open Procurement Albania

**Shtojca 2**

***(e pa aplikueshme për procedurën e hapur)***

**KERKESE PER PROPOZIM**

## Shtojca 3

## Formulari i Deklarimit të Ofertës

Ref: [ ] Data: [ ]
Për: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë.

Përshkrim i shkurtër i Projektit: Projekti Koncesion/PPP i Rrugës Porti i Jahteve - Bypass Orikum - Dukat (Ura e Shën Elizës)

Duke iu referuar Procedurës Konkurruese të sipërpërmendur, ne, të nënshkruarit deklarojmë që:

1. pasi kemi shqyrtuar Dokumentet e Procedurës Konkurruese, ne pranojmë pa rezerva kërkesat, afatet dhe kushtet e deklaruara në Dokumentet e Procedurës Konkurruese;

2. ne plotësojmë të gjitha kërkesat ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike të deklaruara në Dokumentet e Procedurës Konkurruese;

3. Oferta jonë është e vlefshme për periudhën e deklaruar në Dokumentet e Procedurës Konkurruese;

4. nëse oferta jonë pranohet ne do të japim Sigurim Kontrate në përputhje me Dokumentet e Procedurës Konkurruese;

5. ne nuk do të marrim pjesë si Ofertues i Mundshëm në më shumë se një Ofertë për këtë Projekt;

6. ne autorizojmë Autoritetin Kontraktues të verifikojë informacionin dhe dokumentet e bashkëngjitur kësaj Oferte;

7. në pranojmë të nënshkruajmë Kontratën e Koncesionit në formën e draft Kontratës së Koncesionit (siç rregullohet në përputhje me Dokumentat e Procedurës Konkurruese) nëse ne jemi Ofertuesi i Përzgjedhur;

8. ne kuptojmë që ju mund të anuloni Procesin Konkurrues në çdo moment, që ju nuk jeni të detyruar të pranoni asnjë Ofertë që ju mund të merrni dhe që ju i ftoni Ofertuesit e Mundshëm të konkurrojnë për Projektin pa marrë përsipër asnjë përgjegjësi ndaj Ofertuesve të Mundshëm, në përputhje me Dokumentat e Procedurës Konkurruese. Ne pranojmë dhe kuptojmë që Oferta u nënshtrohet dispozitave të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese. Në asnjë rast ne nuk do të kemi pretendime apo të drejtë të çfarëdo lloji natyre nëse Koncesioni nuk na jepet ne.

Perfaqesuesi
Nënshkrimi:
Vula:

Open Procurement Albania

**Shtojca 4**

**FORMULARI I OFERTES**

**Drejtuar**: Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

**Lënda**: Oferta e shoqërisë/Bashkimit te Përkohshëm te Shoqërive për procedure e koncesionit/PPP për Projektin e Rrugës Porti i Jahteve - Bypass Orikum - Dukat (Ura e Shën Elizës)

**Data:** ___.___ .______

Forma e kërkuar te paraqitjes se formularit te ofertës është si me poshtë:

| Nr. | Kriteret | | Reference/vlera e ofertuar |
|---|---|---|---|
| **1** | **Propozimi teknik për ndërtimin e rrugës dhe mirëmbajtjes.** | | |
| | a | Projekt ide/propozim | |
| | b | Metodologjia e punimeve | |
| | c | Plani operacional i mirëmbajtjes dhe disponueshmërisë | |
| | d | Sinjalistika e përkohshme dhe Siguria në kantier gjatë ekzekutimit të punimeve të ndërtimit | |
| **2** | **Ndikimi mjedisor** | | |
| **3** | **Ndikimi social** | | |
| **4** | **Interesi Kapitalit te Vet** | | |
| **5** | **Afati i përfundimit te punimeve** | | |
| **6** | **Oferte Financiare**<br>a) Kosto totale e ndërtimit<br>b) Kosto totale e mirëmbajtjes | | |

______________________________

Nënshkrimi dhe vula e Ofertuesit

Open Procurement Albania

**Shtojca 5**

**FORMULARI I PROPOZIMIT TEKNIK**

Ref: [ ] Data: [ ]
Për: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë.
Procedura Konkurruese:
Përshkrim i shkurtër i koncesionit/ppp:

Duke iu referuar procedurës konkurruese te lartpërmendur, ne, te nënshkruarit deklarojmë se:

Pasi shqyrtuam dokumentet e procedurës konkurruese, paraqesim si pjese te Propozimit tone Teknik sa me poshtë:

...........

....

Përfaqësuesi
Nënshkrimi
Vula

Open Procurement Albania

**Shtojca 6**
*[Letër me kokë e Bankës]*
**Formulari i Garancisë së Ofertës**

**Garancia e Ofertës**

Nr. ref. ______ Datë [  ]

Përfituesi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë se Republikës së Shqipërisë.

Ne jemi informuar se (i/e quajtur këtej e tutje "Ofertuesi") është kërkuar nga ju që të paraqesë para Autoritetit Kontraktues një Garanci të Ofertës në shumën prej [*shuma në shifra dhe fjalë*] si kusht për lejimin e Ofertuesit për të marrë pjesë në ofertën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë në lidhje me Projektin Koncesion/PPP të **Rrugës Porti i Jahteve - Bypass Orikum - Dukat (Ura e Shën Elizës)**.

Ne, [Emri i Bankës], marrim përsipër në formë të pakthyeshme të paguajmë për ju një shumë që nuk tejkalon [*shumën dhe monedhën në fjalë dhe shifra*], pavarësisht nga ndonjë kundërshtim nga ana e Ofertuesit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas pranimit nga ne të kërkesës tuaj të parë me shkrim bërë në përputhje me procedurën e kërkesës detajuar më poshtë.

Kërkesa juaj duhet të pranohet nga ne me ose perpara [shëno datën e skadimit] dhe duhet të shoqërohet me ose përfshijë deklaratën tuaj si më poshtë:

"Ne vërtetojmë se shuma e kërkuar është e pagueshme për shkak se [emri ofertuesit] nuk plotëson detyrimet e tij në përputhje me termat dhe kushtet e ofertës Nr. [shëno numrin]

Çfarëdo kërkese sipas kësaj Garancie duhet të dorëzohet në mënyrën e mëposhtme:
I. me letër, me nënshkrimin (et) në kërkesën e legalizuar nga Banka ose
II. nga bankier juaj me swift / teleks të testuar, ose mjete të tjera të njohura të vërtetuara të teletransmisionit.

Një kërkesë paraqitur me anë te faksit nuk do të pranohet.
Çdo kërkesë dhe deklaratë e bërë në përputhje me procedurën e mësipërme të kërkesës do të pranohet si provë bindëse se shuma e pretenduar është e pagueshme tek ju sipas kësaj Garancie.
Gjithmonë me kusht që:
1. Përgjegjësia jonë në këtë Garanci është e kufizuar në një shumë që nuk kalon në total [shëno monedha dhe vlera në fjalë dhe shifra]
2. Kjo garanci do të përfundojë më ________ dhe çdo kërkesë dhe deklaratë duhet të pranohet nga ne në këtë zyrë në përputhje me procedurën e mësipërme të kërkesës në ose para kësaj date, pas të cilës do të bëhet e pavlerë në qoftë se kthehet tek ne apo jo.
Kjo Garanci është personale dhe nuk është e transferueshme apo nuk mund të tjetërsohet.

Kjo Garanci është subjekt i Rregullores Uniforme për Garancitë Demand, ICC Publikimi Nr.758

***Nënshkrimi dhe vula e Bankës***

**Shtojca 7**

## LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial)

| Lloji, natyra e informacioni që duhet të mbetet konfidencial | Numri i faqes dhe pikat e DSK/PPP që dëshironi të mbetet konfidencial | Arsyet pse ky informacion duhet të mbete konfidencial | Afati kohor që ky informacion të mbete konfidencial |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

Open Procurement Albania

**Shtojca 8**
[*Shtojcë për tu plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË**
**Mbi konfliktin e interesave**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e koncesionit/partneritetit publik Privat që do të zhvillohet në datë____________nga Autoriteti Kontraktor me objekt _____________.

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zv/kryeministri, ministrat, ose zv/ministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatorë, (Këshilli i Mbikëqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barasvlershëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

  Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).
Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhore, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es**

Open Procurement Albania

Unë i nënshkruari_____________________, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _________________ deklaroj nën përgjegjësinë time personale:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 125/2013 “Për koncesionet/partneritetin publik privat”.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** te ligjit Nr.9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

_____________________________

**Vula**

Open Procurement Albania

**Shtojca 9**

[*Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

## I. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

**1.** Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):

a. nuk është në proces falimentimi,
b. nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
c. nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional.

Kërkesat si më sipër, plotësohen me dorëzimin e Ekstraktit të Regjistrit Tregtar për të Dhënat e Subjektit, Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Biznesit, si dhe vetëdeklarimin e subjektit, sipas Shtojcës 10 “Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore.

**2.** Një dokument që vërteton se subjekti juaj:

a) ka plotësuar detyrimet fiskale,
b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, te lëshuar nga Administrata Tatimore.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet te ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore. Këto kritere (pikat 1,2) duhet te vërtetohen përmes dokumenteve të lëshuar jo më parë se (3) tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.

**3.** Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrat përkatës tregtarë të shtetit në te cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor, për vërtetimin e se cilës duhet te paraqesë një kopje ekstraktit.

Open Procurement Albania

Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se ai i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Nëse dokumentet e sipërpërmendur nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentet e lartpërmendur.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, duhet te dorëzohen:

a) Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatoreve ekonomik është krijuar zyrtarisht;
b) Prokura e Posaçme e Përfaqësimit
c) Vendimi i Organeve vendimmarrëse te shoqërisë ose te Bashkimit te Përkohshëm te Shoqërive dhe /ose Konsorciumit

## II. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

**1.** Për të vërtetuar që operatorët ekonomikë janë të kualifikuar, ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimi i ofertës, sipas Shtojcës 6;
b. Përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 11;
c. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 8;
ç. Formulari i deklarimit te ofertës i plotësuar dhe nënshkruar në mënyrë të duhur, sipas Shtojcës 3
e. Formularin e ofertës sipas Shtojcës 4;
f. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për gjitha objektet ku ushtron veprimtarinë, sipas ekstraktit tregtar. Mos shlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi janë në proces ankimi në Gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik. Ky kriter nuk zbatohet për ofertuesit e huaj.

**2.** Për të vërtetuar që operatorët ekonomikë janë të kualifikuar, ofertuesi duhet të paraqesë:

### 2.1 Kapaciteti Ligjor i operatorëve ekonomikë,

Sipas pikës, 1 ”Kritere të Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit”

Ofertuesi i huaj (shoqëri e regjistruar jashtë territorit të Shqipërisë) duhet te vërtetojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura me sipër. Nëse dokumentet e sipërpërmendur në pikat përkatëse nuk lëshohen në shtetin e origjinës të ofertuesit, atëherë ato do të pranohen ne formën e deklaratës me shkrim, nen përgjegjësinë e ofertuesit. Lidhur me deklarimin e mos lëshimit te këtyre vërtetimeve nga institucione të shtetit të origjinës, ofertuesit duhet të paraqesin vërtetim nga Dhoma e Tregtisë së vendit të origjinës - duke evidentuar faktin se ndonjë apo të gjitha vërtetimet e kërkuara nuk lëshohen nga ndonjë institucion publik përgjegjës.

Sipas rastit, Autoriteti Kontraktues do të investigojë nëse këto vërtetime lëshohen apo jo nga institucionet përkatëse ne vendin e origjinës, dhe në rast se konstaton se në shtetin e origjinës ekziston një institucion i cili mund te lëshoj një vërtetim te tille, te paraqitur nga ofertuesi i huaj në formën e vetë deklarimit atëherë Komisioni do te quaj te pavlefshëm dokumentin vetë deklarues te paraqitur.

Në rastet kur operatori ekonomik është anëtar i një holdingu, ai mund te përdorë kapacitetin financiar dhe teknik te këtij te fundit ose te ndonjë prej anëtarëve te tjerë ne këtë holding, vullnet i cili duhet te jete i shprehur me vendim te organeve vendimmarrëse te përcaktuara ne statutin e tij. Ne rastet e kërkesave te shtojcës 10, do te plotësohen si prej operatorit ekonomik pjesëmarrës edhe prej anëtarit/ve te holdingut kapacitetet e te cilëve operatori ekonomik do te përdorë.

Ne rastet e bashkimit te përkohshëm te shoqërive, si dhe ne rastin e përcaktuar me sipër, kërkesat e shtojcës 10 janë te detyrueshme për secilin prej anëtareve te këtij bashkimi ne masën e marrëveshjes se bashkimit te përkohshëm te operatoreve ekonomik.

**Legalizimi i dokumentacionit**

Dokumentet e siguruara jashtë territorit të Shqipërisë nga subjekte juridike të huaja duhet të jenë të legalizuara në mënyrë që të kenë vlerë ligjore. Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëritë që kanë regjistrim në shtetet anëtare të Konventës se Hagës (5 TETOR 1961) duhet të përmbajë vulën apostile në përputhje me ligjin Nr. 9060, date 8.5.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë ne Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja".

**Bashkimi i përkohshëm i shoqërive**

Operatorët ekonomikë mund të ofertojnë të vetëm ose të krijojnë grupe operatorësh ekonomikë dhe të ofertojnë si një kandidat i vetëm. Në rast të bashkimit të grupeve të operatorëve ekonomikë, autoriteti kontraktues duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Oferta mund të paraqitet nga një grup operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e punëve dhe e shërbimeve do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi.

Para dorëzimit të ofertës, grupi i operatorëve duhet të paraqesë zyrtarisht një kopje të marrëveshjes së konsorciumit të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e saj, të noterizuar përpara një noteri, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi.

Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e grupit caktojnë, me prokurë, përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në procedurë në emër të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë.

Open Procurement Albania

Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi, nëse nuk kërkohet ndryshe në dokumentet e tenderit.

Çdo operator ekonomik duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe ato të përcaktuara në dokumentet e procedurës konkurruese.

"Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë grupi, i marrë së bashku.
Operatori ekonomik, pjesëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht dhe oferta individuale.

Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës dhe përpara shpalljes së ofertuesit fitues, në të kundërt oferta e tij refuzohet.

Në rast falimentimi të përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, Autoriteti Kontraktor mund të vazhdojë kontratën me një operator tjetër ekonomik, i caktuar si përfaqësues i grupit dhe i propozuar nga anëtarët e tjerë jopërfaqësues, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën, përndryshe, autoriteti kontraktor mund të tërhiqet nga kontrata. Në rast se këto rrethana i ndodhin operatorit tjetër ekonomik, nëse përfaqësuesi i grupit nuk cakton një zëvendësues, atëherë detyrimet e operatorit të dështuar ekonomik mund të merren përsipër nga përfaqësuesi ose nga një anëtar tjetër i grupit, me kusht që ky të plotësojë kërkesat.

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Ofertuesi, duhet të paraqesë bilancet e konsoliduara dhe pasqyrat financiare të audituara nga ekspert(e) kontabël, për tre (3) vitet te fundit ushtrimore financiare; (2015-2016-2017)

**2.2.2** Ofertuesi duhet të dëshmojë nëpërmjet pasqyrave financiare te audituara te 3 (tre) viteve te fundit, (si me larte) se ka pasur aktivitet ekonomik pozitiv te qëndrueshëm financiare.

**2.2.3** Ofertuesi duhet të ketë xhiro kumulative te (3) viteve të fundit jo me pak 50 % të vlerës se kostos totale te ndërtimit (TVSH nuk përfshihet);

Ofertuesi domosdoshmerisht duhet të dëshmojë që disponon vlera të mjaftueshme financiare për te realizuar këtë projekt. Për te vërtetuar plotësimin e këtij kushti ofertuesi duhet të paraqesë vërtetim se ka gjendje financiare bankare, likuiditete, apo mjete te tjera financiare në vlerën jo më pak se 3% të vlerës vlerës se ndërtimit te ofruar (Kosto totale e projektit sipas percaktimit te pikes 3/i si me poshte), për qëllim te realizimit vetëm te këtij projekti, lëshuar jo më pare se 5 (pese) ditë nga dita e hapjes së ofertave. Mosplotesimi i ketij kushti, perben shkak skualifikimi.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë Plan biznesi për të gjithë kohëzgjatjen e projektit; Struktura e Plan Biznesit duhet të përmbajë të paktën treguesit e mëposhtëm.

(i) Kosto totale e Projektit (Vlera e ndërtimit, projektim dhe mirëmbajtje):
*Shënim: Zëri i TVSH- se të paraqitet si zë i veçantë.*

(ii) Mënyra e financimit (Burimet e Financimit):
- % e vlerës së projektit që do të financohet me kapitalin e vet;
- % e vlerës së projektit që do të financohet me kredi.

(iii) Kushtet dhe grafiku i shlyerjes së kredisë:
- Periudha e shlyerjes;
- Norma e interesit;
- Momenti i fillimit të shlyerjes së kredisë.

(iv) Shpenzimet operative (shpenzimet vjetore që do të kryhen për mbarëvajtjen e aktivitetit):
- Shpenzime mirëmbajtje;
- Shpenzime personeli;
- Amortizimi vjetor.

(v) Të ardhurat: Në bazë të treguesve të mësipërm të hartohen pasqyrat përkatëse:
- Pasqyra “Te Ardhura dhe Shpenzime”,
- Pasqyra “Cash - Flow” (lëvizja e parasë).

(vi) Për përcaktimin e rentabilitetit të projektit të llogariten:
- Treguesit e VAN – se; (vlera aktuale neto)

(vii) Treguesit e normës së brendshme të kthimit (IRR – së;)

(viii) Periudha e vetëshlyerjes së investimit;

(ix) Grafiku i projektit

## 2.3 Kapaciteti teknik:

Vlerësimi i kapacitetit teknik ne Ndërtim, të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentet e mëposhtme:

### 2.3.1 Punët e ngjashme:

*2.3.1.1.Projekte te ngjashme do te konsiderohen ato projekte te cilat te gjitha se bashku* bazuar

ne kompleksitetin dhe karakteristikat e punimeve te këtij projekti, duhet te përmbushin minimumi këto aktivitete kryesore:

| # | **Projekte te ngjashme / punët e kërkuara – 2013 - 2017** | **Sasia** | **Njësia** |
|---|---|---|---|
| 1 | Gërmime toke dhe shkëmbi | **150 000** | **m3 / 5 vite** |
| 2 | Mbushje trup rruge argjinature | **70,000** | **m3 / 5 vite** |
| 3 | Shtrim /ngjeshje nën-bazë dhe stabilizant rruge | **30,000** | **m3 / 5 vite** |
| 4 | Betone te klasave te ndryshme | **6,000** | **m3 / 5 vite** |
| 5 | Asfalte & Binder | **15,000** | **ton / 5 vite** |

*2.3.1.2.*Operatori ekonomik kërkohet që të ketë patur kontrata për Ndërtim Rrugësh**,** te realizuara me sukses ne 10 vitet e fundit mbi 50 km**,** nga te cilat jo me pak se 8 km te jene përfunduar domosdoshmërisht ne një kontratë te vetme 5 vitet e fundit. Për te shmangur çdo dyshim, në qoftë se ofertuesi i ka realizuar këto punime ne formën e një bashkimi Operatoresh dhe /ose konsorciumi, pjesëmarrja ne te duhet te ketë qene jo me pak se 60%.

*2.3.1.3.*Operatori ekonomik kërkohet që të ketë patur kontrata për Mirembajtje Rrugësh**,** te realizuara me sukses ne 10 vitet e fundit, jo me pak se 100 km**,** nga te cilat jo me pak se 50 km te jene përfunduar domosdoshmërisht ne një kontratë te vetme 3 vitet e fundit. Për te shmangur çdo dyshim, në qoftë se ofertuesi i ka realizuar këto punime ne formën e një bashkimi Operatoresh dhe /ose konsorciumi, pjesëmarrja ne te duhet te ketë qene jo me pak se 45%.

